

## *Në dhjetëvjetorin e “Haemusi-t”*

ANTON ÇEFA



U mbushën plot dhjetë vjet që filloi të botohet “Revista Haemus”. Mirënjohje dhe falënderim janë fjalë të varfëra për t’ju drejtuar atyre që e krijuan, e botuan dhe vazhdojnë ta botojnë: zotërinjve Kopi dhe Ardian Kyçyku, at dhe bir. Atëherë e sot, ajo na u bë një mikeshë e dashur, e mirë dhe e urtë për secilin prej nesh që patëm fatin ta marrin ndër duar. Ia di shumë për nder albanologut gjerman Hans Joachim-Lanksch që më pati njoftuar porsa doli numri i parë i revistës. Dhe nuk më shkoqen nga kujtesa fjalët e saj të para: “Revista Haemus” del në një moment kur fanitja e një reviste të re, apo që synon të jetë e re, duket marrëzi për shumë arsye. Dhe nuk është e lehtë të marrish përsipër një marrëzi të tillë, por nuk është as e pamundur”. Fjalë ari! Kyçykët me punën e tyre e hodhën poshtë “të pamundurën” dhe revista jo vetëm u fanit, ajo shkëlqeu gjatë dhjetë viteve dhe shkëlqen sot e kësaj dite me urtinë e saj: “Felix qui potuit rerum cognoscere causas”.

Në fillim nuk e pata kuptuar atë emërtimin disi të çuditshëm të saj “Haemus”, por shpejt u sqarova se, duke qenë një emërtim romak, ajo mbante një të vërtetë të madhe, të vërtetën e trevave të lashta e të stërlashta ballkanike, që do të na shpaloseshin nga numri në numër, nga fleta në fletë, në këtë revistë evropiane dygjuhëshe kulture dhe traditash. Duhej ndriçuar tradita e popujve të lashtë të trojeve haemusiane për ta njohur më mirë njëri-tjetrin dhe për ta dashur më shumë, dhe të përtërihej e të forcohej më tej ajo në një dritë të re kulture e qytetërimi modern; në mënyrë që së bashku “këta dy popuj aq të afërt shpirtërisht “të shtrihen si një urë drejt kulturës evropiane tani që brigjet nuk mungojnë”. Qëllim e program mbi të gjitha qëllimet e programet. Nuk mund të ketë bashkëpunim pa mirëkuptim, dhe nuk mund të ketë mirëkuptim pa njohje, dhe njohjen e bie kultura dhe bashkë me të, dashurinë. Kështu “Haemus” eci dhe ecen si një “Revistë evropiane dygjuhëshe kulture dhe traditash”, në të cilën qesin krye herë pas here edhe italishtja, frëngjishtja, anglishtja, greqishtja.

Periudha që pasoi e që pason regjimin komunist kërkonte dhe kërkon ende çlirim shpirtëror që frymon gjithnjë tolerancë, mirëkuptim, veprim të përbashkët, integrim shpirtëror. Vetëm në këtë terren mund të pllenohen virtytet e së mirës, së vërtetës, së bukurës, tri elementet themelore të idealit human. Ndoshta, më shumë se kushdo tjetër, e ndjenin këtë nevojë – nevojën e çlirimit shpirtëror - popujt e Ballkanit, ku si këpurdhat kanë gjallitur mendësitë e mykura antagoniste etnike, fetare, kulturore, etj. Vetëm kultura është mjeti më i frytshëm për t’i shuar ato dhe për t’i fisnikëruar shpirtërat; ajo është arti që e përplotëson njeriun, e humanizon atë. Është ajo që na ndihmon “të konvertohemi” nga qytetarë ballkanas në qytetarë evropianë, duke njohur e ruajtur vlerat tona dhe duke i pasuruar ato me vlerat evropiane. “Revista Haemus”, që me çdo numër të befason me përmbajtjen e saj, bëri gjatë këtyre viteve një punë të palodhur e të përkushtuar, duke i pajisur shumë rumun me zemër shqiptare dhe shumë shqiptarë me zemër rumune dhe të gjithë me mendje e shpirt evropian.

Për dhjetë vite me radhë, “Haemus-i” foli me urtinë e shtrirë në hullitë më të ndryshme të dijeve e të arteve. Duke u paraprirë nga letërsia dhe shkenca e saj, kritika letrare, u trajtuan aty probleme nga më të ndryshmet të historisë, filozofisë, teologjisë, sociologjisë, etnografisë, etnopsikologjisë, folklorit, leksikologjisë, eseistikës, gjeografisë, etj., jo vetëm të trevave ballkanike, po edhe të atyre evropiane dhe botërore. Prandaj, ajo është quajtur “një urë e hapur”, d.m. th. “një urë, nga harqet e së cilës mund të zgjaten edhe ura drejt popujsh e kulturash tjera”.

Tek Haemus-i, si në një “odë burrash virtuale”, siç e ka quajtur atë drejtuesi dhe botuesi i saj, Akademik Kopi Kyçyku, mbledhen personalitete të kulturës, shkencës, religjionit, artit, etj., nga Shqipëria, Rumania, Greqia, Maqedonia, Gjermania, Franca, Holanda, Amerika, etj. dhe si miq të vjetër shkëmbejnë biseda dhe rrahin mendime. Duke folur për Haemus-in, personaliteti i lartë i kulturës dhe shkencës rumune, autor i mbi dy mijë veprave me karakter letrar, historik e dokumentar, e ka vlerësuar atë “një revistë paraprirëse e trullit të ri kulturor të mijëvjetëshit” dhe “një revistë që përpiket të ofrojë përfundime sociologo-filozofike me interes të përgjithshëm, duke qenë nga kjo pikëpamje unike në llojin e vet”.

Natyrshëm që vëllimi i madh punës botuese që kërkon një revistë e tillë ndeshet me atë problemin më të vështirë të shtypit, financimin, që mbetet gjithnjë i pazgjidhshëm. Është paradoksale të mendosh që shteti ynë i ditëve tona as që e vë ujën në zjarr për këtë problem, edhe pse revista me shërbimin që i bën kulturës dhe jo vetëm kulturës po edhe çështjes kombëtare, e ka merituar prej vitesh një gjë të tillë. E atëherë? Sa mund të ofrojnë bashkëpunëtorët? Për vete, po them vetëm këtë: kam marrë falas revistën dhe nuk kam qenë në gjendje të paguajë as edhe një qindarkë për postën dhe as për një antologji të poezisë sime që u përkthye në rumanisht dhe u botua nga Kyçykët. Borxh i papaguar.

Në prill të vitit 2006, kjo odë miqësie burrash u institucionalizua nga Kyçykët, at e bir, në “Shoqërinë Kulturore Shqiptare Haemus”, e cila i ka vënë vetes, ndër të tjera, detyra të tilla si ruajtjen e identitetit kulturor shqiptar, promovimin e kulturave të popujve shqiptarë e rumun, integrimin e kulturës sonë në circuitet evropiane e botërore, shkëmbimin e informacionit kulturor, etj., dhe si kryedetyrë: “t’ua bëjë të njohura sa më qartë Evropës e botës vlerat e pashtershme qytetëruese, demokratike dhe progresiste të kombit shqiptar.”

Shoqëria ka shtëpinë e vet botuese “Librarium Haemus”, tek e cila janë botuar e po botohen herë pas here vepra të autorëve shqiptarë në gjuhën rumune, për t’ia bërë të njohur popullit mik rumun kulturën e sidomos letësinë tonë. Një punë me vlera të pakrahasueshme.

Së fundi, për ta pasuruar disi “varfërinë” e mirënjohjes dhe të falënderimit, që ua adresova në fillim të këtij shkrimi Kyçykëve, at e bir, po i shtoj urimin tim të dalë zemre për shëndetin, mbarësinë dhe sukseset e mëtejshme në veprimtarinë e tyre shembullore në dobi të kulturës dhe të çështjes sonë kombëtare.

*USA, janar 2009*